

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-264

VESHJE IZOLUESE EPOKSIDE ME 2 PËRBËRËS QË APLIKOHET ME RUL

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-264 është rrëshirë epokside me ngjyrë dhe me 2 përbërës. "Përbërje totale epokside solide sipas metodës së testimit Deutsche Bauchemie e.V. (Unioni gjerman për kimikatet e ndërtimit)"

PËRDORIMET

Sikafloor®-264 duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

Sikafloor®-264 përdoret si:

- Veshje që aplikohet me rul për llaçe betoni dhe çimentoje për dysheme me konsumim normal deri në mesatar p.sh. salla montimi dhe magazinimi, punishte mirëmbajtjeje, garazhe dhe rampa ngarkimi.
- Veshje izoluese për sistemet me spërkatje rëre, si ndërtesat shumëkatëshe dhe parkimet nëntokësore, hangarë mirëmbajtjeje dhe për zona ku kryhen procese të lagështa, p.sh. industri ushqimesh dhe pijesh.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE


- Rezistencë e mirë kimike dhe mekanike
- Aplikim i lehtë
- Kundër lëngjeve
- Finiturë e shkëlqyeshme
- Mundësi për sipërfaqe rezistente ndaj rrëshqitjes

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

Pajtohet me LEED v2009 IEQc 4.2: Materiale me çirime të ulëta - Bojëra & Veshje

MIRATIME / STANDARDE

- Certifikatë çlirimi grimcash Sikafloor-264 Deklaratë Kualifikimi CSM - ISO 14644-1, kategoria 4 - Raport Nr. SI 0904-480 dhe GMP kategoria A, Raport Nr. SI 1008-533.
- Certifikatë çlirimesh degazimi Sikafloor-264: Deklaratë Kualifikimi CSM - ISO 14644-8, kategoria 6,5 - Raport Nr. SI 0904-480.
- Rezistencë biologjike e mirë sipas ISO 846, CSM Raport Nr. 1008-533
- Klasifikimi ndaj zjarrit sipas EN 13501-1, Raport Nr. 2013-B-2119/01, MPA Dresden, Gjermani, qershor 2013.
- Llaç dyshemeje rrëshirë sintetike sipas EN 13813:2002, Deklaratë Performance 02 08 01 02 05 00000003 1008, mbart markën CE.
- Veshje për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit sipas EN 1504-2:2004, Deklaratë Performance 02 08 01 02 05 00000003 1008, certifikuar nga organi i kontrollit të njoftuar të prodhimit në fabrikë 0921, certifikatë konformiteti nga kontrolli i prodhimit në fabrikë 2017, dhe mbart markën CE.
- Certifikatë Konformiteti ISEGA 40974 U15



INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Epoksid		
Ambalazhi	Përbërësi A	enë 23,7 kg	
	Përbërësi B	enë 6,3 kg	
	Përbërësit A+B	njësi 30 kg gati për përzierje	
	Përbërësi A	fuçi 220 kg	
	Përbërësi B	fuçi 59 kg	
	Përbërësit A+B	fuçi 177 kg	
	Përbërësit A+B	1 fuçi përbërësi A (220 kg) + 1 fuçi përbërësi B (59 kg) = 279 kg 3 fuçi përbërësi A (220 kg) + 1 fuçi përbërësi B (177 kg) = 837 kg	
Paraqitja / Ngjyra	Rrëshira - përbërësi A	lëng me ngjyrë	
	Forcuesi - përbërësi B	lëng transparent	
	Shumëllojshmëri ngjyrash		
	RAL 1001, 6021, 7030, 7032, 7035, 7037, 7038, 7040, 7042, 9002 Ngjyra të tjera me porosi. Nën dritë diellore të drejtpërdrejtë, mund të ketë çngjyrosje dhe ndryshim të ngjyrës; kjo nuk ndikon mbi funksionin dhe performancën e veshjes.		
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit		
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C.		
Dendësia	Përbërësi A	~ 1,64 kg/l	(DIN EN ISO 2811-1)
	Përbërësi B	~ 1,00 kg/l	
	Rrëshira e përzierë	~ 1,40 kg/l	
	Të gjitha vlerat e dendësisë në +23°C.		
Përmbajtja e substancave të ngurta për ~100 % peshë			
Përmbajtja e substancave të ngurta për ~100 % vëllim			

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore D	~76 (7 ditë / +23 °C)	(DIN 53 505)
Rezistenca ndaj abrazionit	~35 mg (CS 10/1000/1000) (7 ditë / +23 °C)	(DIN 53109)
Rezistenca ndaj ngjeshjes	~53 N/mm ² (mbushur me rrëshirë 1:0.9 me F34) (28 ditë / +23 °C)	(EN196-1)
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	~20 N/mm ² (mbushur me rrëshirë 1:0.9 me F34) (28 ditë / +23 °C)	(EN 196-1)
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	>1,5 N/mm ² (dështim betoni)	(ISO 4624)
Rezistenca kimike	Rezistencë ndaj shumë kimikateve. Kontaktoni me shërbimin teknik Sika për informacione specifike.	
Rezistenca termike	Ekspozimi*	Nxehtësi e thatë
	I përhershëm	+50 °C
	Afatshkurtër max. 7 ditë	+80 °C
	Afatshkurtër max. 12 orë	+100 °C

Lagështi/nxehtësi e lagësht afatshkurtër* deri në +80 °C ku ekspozimi është vetëm rastësor (pastrim me avull, etj.).

*Pa ekspozim të vazhdueshëm kimik dhe mekanik dhe vetëm në kombinim me sistemet Sikafloor® si sistem me spërkatje rëre në ~ 3-4 mm trashësi.

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Sistemet	Ju lutemi referohuni në skedën teknike të sistemit:	
	Sikafloor® MultiDur ES-14	Veshje me ngjyrë të njëtrajtshme e aplikuar me rul
	Sikafloor® MultiDur EB-24	Veshje epokside për dysheme me ngjyrë të njëtrajtshme dhe rezistencë mekanike të lartë
	Sikafloor® MultiDur ES-26	Veshje epokside e lëmuar me ngjyrë të njëtrajtshme për dysheme
	Sikafloor® MultiDur EB-14	Shtresë e hollë veshjeje epokside për dysheme me ngjyrë të njëtrajtshme dhe me spërkatje rëre
	Sikafloor® MultiDur EB-14 ECC	Shtresë e hollë veshjeje epokside 264 për dysheme me ngjyrë të njëtrajtshme mbi llaçin e dyshemesë epoksid hibrid dhe me spërkatje rëre

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : përbërësi B = 79 : 21 (për peshë)													
Konsumimi	~0,25–0,3 kg/m ² veshje e aplikuar me rul ~0,9–1,2 kg/m ² /mm aplikuar si një shtresë konsumimi e vetënivelueshme Këto vlera janë teorike dhe nuk përllogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon etj. Për informacione të detajuara, ju lutemi referohuni në skedën teknike të sistemit Sikafloor® MultiDur ES-14 dhe Sikafloor® MultiDur ES-24													
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.													
Lagështia relative e ajrit	max. 80 % lagështi relative													
Pika e vesës	Kujdes kondensimin! Nënshtresa dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3°C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit ose çngjyrosjes mbi sipërfaqen përfundimtare. Shënim: Temperaturat e ulëta dhe lagështia e lartë shtojnë mundësinë e çngjyrosjes.													
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +30 °C max.													
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	< 4 % pjesë për peshë përmbajtje lagështie. Metoda e testimit: matësi Sika®-Tramex, matja CM ose tharje në furrë. Pa lagështi rritëse sipas ASTM (fletë polietileni).													
Koha e punueshmërisë	<table><thead><tr><th>Temperatura</th><th>Koha</th></tr></thead><tbody><tr><td>+10 °C</td><td>~ 50 minuta</td></tr><tr><td>+20 °C</td><td>~ 25 minuta</td></tr><tr><td>+30 °C</td><td>~ 15 minuta</td></tr></tbody></table>	Temperatura	Koha	+10 °C	~ 50 minuta	+20 °C	~ 25 minuta	+30 °C	~ 15 minuta					
Temperatura	Koha													
+10 °C	~ 50 minuta													
+20 °C	~ 25 minuta													
+30 °C	~ 15 minuta													
Koha e maturimit	Përpara aplikimit të Sikafloor®-264 mbi Sikafloor®-264 lini: <table><thead><tr><th>Temperatura e nënshtresës</th><th>Min.</th><th>Max.</th></tr></thead><tbody><tr><td>+10 °C</td><td>30 orë</td><td>3 ditë</td></tr><tr><td>+20 °C</td><td>24 orë</td><td>2 ditë</td></tr><tr><td>+30 °C</td><td>16 orë</td><td>1 ditë</td></tr></tbody></table> Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.		Temperatura e nënshtresës	Min.	Max.	+10 °C	30 orë	3 ditë	+20 °C	24 orë	2 ditë	+30 °C	16 orë	1 ditë
Temperatura e nënshtresës	Min.	Max.												
+10 °C	30 orë	3 ditë												
+20 °C	24 orë	2 ditë												
+30 °C	16 orë	1 ditë												

Produkti i aplikuar gati për përdorim	Temperatura	Qarkullim këmbësorësh	Qarkullim i lehtë	Tharja e plotë
	+10 °C	~ 72 orë	~ 6 ditë	~ 10 ditë
	+20 °C	~ 24 orë	~ 4 ditë	~ 7 ditë
	+30 °C	~ 18 orë	~ 2 ditë	~ 5 ditë

Shënim: Kohët jepen më përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Sipërfaqja e betonit duhet të jetë e qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme ndaj kompresionit (min. 25 N/mm²) dhe me rezistencë min. ndaj tërheqjes prej 1.5 N/mm².
- Nënshtrësia duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa ndotje si papastërtitë, vaji, graso, veshje dhe produkte për trajtimin e sipërfaqes, etj.
- Nënshtrësat e betonit duhet të përgatiten mekanikisht duke përdorur pastrim me rrymë gërryerje ose pajisje gërvishitjeje për të hequr mbetjet e çimentos dhe për të arritur një sipërfaqe të teksturuar.
- Betoni i dobët duhet të hiqet dhe defektet e sipërfaqes si vrimat dhe boshllëqet duhet të ekspozohen plotësisht.
- Riparimet mbi nënshtrësë, mbushja e vrimave/hapësirave dhe nivelimi i sipërfaqes duhet të bëhen me anë të përdorimit të produkteve të përshtatshme nga materialet e serisë Sikafloor®, SikaDur® dhe Sikagard®.
- Pluhuri, materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë ose vakuum.

PËRZIERJA

Përpara përzierjes, përzieni Përbërësin A mekanikisht. Kur i gjithë përbërësi B të jetë shtuar tek përbërësi A, përzieni vazhdimisht për 3 minuta derisa të përftohet një përzierje e njëtrajtshme. Kur përbërësit A & B janë përzierë, shtoni rërën e kuarcit dhe nëse kërkohet Extender T dhe përzieni edhe për 2 min. të tjera derisa të arrihet një përzierje uniforme. Për të siguruar përzierjen e plotë, hidhini materialet në një enë tjetër dhe përzieni përsëri për të përfutur një përzierje konsistente. Duhet shmangur përzierja e tepruar, për të pakësuar bllokimin e ajrit.

Veglat e përzierjes

Sikafloor®-264 duhet të përzihet plotësisht me mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300 - 400 rpm) ose pajisje tjetër të përshtatshme. Për përgatitjen e llaçeve përdorni një mikser me veprim të detyruar dhe kovë rrotulluese. Mos përdorni mikser më rënie të lirë.

APLIKIMI

Përpara aplikimit, konfirmoni përmbajtjen e lagështisë, lagështinë relative të ajrit dhe pikën e vesës. Nëse përmbajtja e lagështisë është > 4 % pjesë për peshë, Sikafloor® EpoCem® mund të aplikohet si një sistem barriere të përkohshme lagështie (T.M.B, temporary

moisture barrier).

Prajmer:

Sigurohuni se një veshje e vazhdueshme dhe pa pore mbulon nënshtrësën. Nëse nevojitet, aplikoni 2 veshje prajmeri. Aplikoni Sikafloor®-156 / 161 /-160 me furçë, rul ose shkop gome.

Preferohet aplikimi me shkop gome vertikalisht & horizontalisht.

Nivelimi:

Sipërfaqet e ashpra duhet të nivelohen më përpara. Prandaj përdorni p.sh. llaçin nivelues Sikafloor®-156/-161/-160 (shih skedën teknike).

Veshje:

Sikafloor®-264 si veshje, mund të aplikohet me rul me qime të shkurtëra (vertikalisht & horizontalisht).

Veshje izoluese:

Veshjet izoluese duhet të aplikohen me shkop gome dhe pastaj vertikalisht & horizontalisht me rul me qime të shkurtëra.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Thinner C menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

MIRËMBAJTJA

Për të ruajtur paraqitjen e dyshemesë pas aplikimit, të gjitha rrjedhjet duhet të hiqen menjëherë nga Sikafloor®-264 dhe duhet të pastrohet rregullisht me furçë rrotulluese, pajisje tharëse, pastrues me presion të lartë, teknika larjeje dhe vakuumi etj. duke përdorur detergjent dhe dyll të përshtatshëm.

DOKUMENTA SHITESË

Cilësia & përgatitja e nënshtrësës

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "VLERËSIMI & PËRGATITJA E SIPËRFAQEVE PËR SISTEMET E DYSHEMEVE".

Udhëzime aplikimi

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "PËRZIERJA & APLIKIMI I SISTEMEVE TË DYSHEMEVE".

Mirëmbajtja

Ju lutemi referohuni tek "Sikafloor® - REGJIMI I PASTRIMIT".

KUFIZIME

- Mos aplikoni Sikafloor®-264 mbi nënshtresa me lagështi në rritje
- Mos spërkatni me tepri rërë kuarci mbi prajmerin.
- Sikafloor®-264 i sapo aplikuar duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe uji për të paktën 24 orë.
- Për zona me ekspozim të kufizuar dhe sipërfaqe betoni me absorbueshmëri normale nuk nevojitet lyerja me prajmerin Sikafloor® -156/-161/-160 për sistemet që aplikohen me rul ose me veshje të teksturuar.
- Për veshje me rul / teksturë: Nënshtresat e pabarabarta, ashtu si dhe nënshtresat e ndotura nuk mund dhe nuk duhet të mbulohen me veshje të holla izoluese. Prandaj, nënshtresa edhe zonat përreth duhet të përgatiten dhe të pastrohen gjithmonë shumë mirë përpara aplikimit.
- Vlerësimi dhe trajtimi i gabuar i plasaritjeve mund të sjellë reduktimin e kohëzgjatjes së funksionimit dhe plasaritje reflektive.
- Për përputhje të saktë ngjyre, sigurohuni se Sikafloor®-264 është aplikuar në çdo zonë nga i njëjti numër serie prodhimi (batch number).
- Nën kushte të caktuara, ngrohja nën dysheme e kombinuar me ngarkesë të madhe pikësore, mund të lëjnë shenja tek rrëshira.
- Nëse nevojitet ngrohje, mos përdorni ngrohës që funksionojnë me gaz, vajguri ose të tjera lëndë djegëse fosile, pasi prodhojnë sasi të lartë avujsh CO₂ dhe H₂O, që mund të ndikojnë negativisht mbi shtresë. Për ngrohje përdorni vetëm sisteme elektrike ventilimi ajri të ngrohtë.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikafloor®-264
Mars 2019, Botimi 08.01
020811020020000055

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / j lloji sb) 500 g/l (Kufizimi 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikafloor®-264 është < 500 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sikafloor-264-sq-AL-(03-2019)-8-1.pdf

